



BULETINI

NR.16, VITI XII, 01.I.2019-31.X.2019

- Intervistë me Kryeshefin Ekzekutiv të KOSTT z.Illir M. Shala
- Inaugurohet Nënstacioni 110/10(20)kV Ilirida dhe linjat nëntokësore transmetuese 110 kV
- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë publikoi Opinionin mbi vendimin preliminar të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë mbi certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Energjisë – KOSTT sh.a.
- U mbajt takimi i parë i Grupit Punues për Ballkanin në kuadër të Iniciativës për Sigurinë Kibernetike (UCSI), pjesë e së cilës është edhe KOSTT

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRŽIŠTA A.D.



Intervistë me Kryeshefin Ekzekutiv të KOSTT z. Ilir M. Shala.....	3
Ambasadori i RF Gjermane z. Christian Heldt vizitoi Nënstacionin 400/110kV Peja 3.....	6
Inaugurohet Nënstacioni 110/10(20)kV Ilirida dhe linjat nëntokësore transmetuese 110 kV.....	7
Sekretariati i Komunitetit të Energjisë publikoi Opinionin mbi vendimin preliminar të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë mbi certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Energjisë – KOSTT sh.a.	8
KOSTT edhe një hap para, drejt anëtarësimit në ENTSO-E.....	9
KOSTT realizon vizitë në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Maqedonisë së Veriut-MEPSO.....	10
KOSTT Kompania e parë publike, e cila në drejtim të masave të sigurisë për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera realizon simulim/ushtrim të gjendjes emergjente.....	10
KOSTT pjesë e iniciativës Mbjell një Pemë/Plant a Tree Challenge Kosovo.....	11
KOSTT vazhdon të kontribuoj në mirëqenien e fëmijëve të Kosovës.....	11
Kryeministri i Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj priti në takim Kryeshefin Ekzekutiv të KOSTT z. Ilir M. Shala.....	12
KOSTT vazhdon me vizitat në kërkim të përkrahjes së të bërit Zonë/Blok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale.....	12
KOSTT pjesë e kampanjës vjetore të Ditës Ndërkombëtare të Gruas/IWD 2019 përmes iniciativës Balance for Better/Balanco për më mirë.....	13
KOSTT Inauguron edhe një projekt madhor- Nënstacioni 220/10(20)kV Drenasi dhe linja e dyfishtë transmetuese 220kV.....	14
KOSTT realizon vizitë në OST-në Bullgare në funksion të përkrahjes për t'u bërë Zonë/Blok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale.....	16
Vazhdojnë takimet e menaxhmentit të KOSTT-it në kërkim të mbështetjes për t'u bërë Zonë/Blok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale.....	16
CGES e Malit të Zi, mbështet KOSTT-in në drejtim të të bërit Zonë/Blok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale.....	17
Kosova dhe Shqipëria të përkushtuara për avancimin e bashkëpunimit në mes të dy sistemeve energjetike.....	17
U mbajt takimi i parë i Grupit Punues për Ballkanin në kuadër të Iniciativës për Sigurinë Kibernetike (UCSI), pjesë e së cilës është edhe KOSTT.....	18
Siguria Kibernetike në fushën e Energjisë.....	18
Swissgrid përkrahë KOSTT në drejtim të të bërit Zonë/Blok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale.....	20
Kryeministri i Kosovës z. Ramush Haradinaj vizitoi KOSTT-in, pas rezultatit të arritur në drejtim të operimit të pavarur si Zonë/Blok Rregullues në kuadër të Evropës Kontinentale.....	20
Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT merr pjesë në Javën për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kosovë.....	21
Përgjegjësia Shoqërore e Korporatave (CSR) -Koncept menaxhimi për të rritur impaktin pozitiv në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm.....	22
Ambasadorja e Finlandës Sh.S.znj. Stjernvall ligjëroi pranë të rinjve të KOSTT të përzgjedhur për programin e lidhshimit.....	23
KOSTT sh.a hap dyert për tregun dy ditor, në përkrahje të produkteve bujqësore vendore.....	23
KOSTT sh.a pjesë e programit të lidhshimit ekzekutiv për çështje gjinore GEELP.....	24
Nga Tetori 2019, qendra e Prishtinës me furnizim më të besueshëm dhe kualitativ me energji elektrike - Kryeqytetit i shtohet edhe një Nënstacion me teknologjinë e fjalës së fundit.....	25
Vajzat marrin lidhshimit në KOSTT për të promovuar fuqi të barabarta, liri dhe përfaqësim- KOSTT i bashkohet iniciativës globale #GirlsTakeover / Vajzat marrin përsipër, në Ditën Ndërkombëtare të Vajzës.....	25

Intervistë me Kryeshefin Ekzekutiv të KOSTT z.Illir M. Shala

z.Shala, nga muaji mars 2018 ju morët nën udhëheqje KOSTT-in, na thuani cili ka qenë motivi i juaj për të konkurruar për këtë pozitë?

Një Kryeshef Ekzekutiv (KE) duhet të jetë vizionar dhe strateg, që përcakton drejtimin në të cilin duhet të shkojë ndërmarrja.

Kam dashur dhe dua që punën që bëj si KE i KOSTT-it, të jetë gjurmë pozitive për brezat e ardhshëm. Po ashtu besoj se puna, që bëj, mund të shërbejë si frymëzim për të tjerët në ekip.

Përballja me sfidat dhe zgjidhja e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme gjatë karrierës sime, më ka bërë që të konkurroj në pozitën e KE.

Duke e parë nevojën për harmonizim të raporteve brenda kolektivit dhe raportet me akterët e tjerë në sektorin e energjisë në Kosovë si: ZRRE, KEK, KEDS, KESCO etj si dhe tutje stagnimin e KOSTT në arenën ndërkombëtare gjatë viteve 2015-2017, kanë qenë faktorët kyçë dhe dominantë që kam konkurruar në pozitën e KE. Siç e dini, unë kam lindur profesionalisht dhe zhvilluar në këtë kompani që nga viti 1999 dhe e shihja këtë si momentin e duhur për ta vendosur KOSTT-in në një rrugë drejt suksesit. Dhe, besoj që këto sfida i tejkaluam në kontekstin e brendshëm si dhe në atë ndërkombëtarë tashmë gjërat filluan të lëvizin. Jam i pasionuar pas punës dhe kompanisë, kështu që nuk do të ndalem te asgjëja për ta realizuar vizionin, misionin dhe objektivat e kompanisë.

Motivimi për një KE mund të vijë nga vetë njerëzit me të cilët është i rrethuar. Kur një KE beson se ka mendje të ndritshme përreth tij, të cilët janë aq të pasionuar dhe të investuar në suksesin e kompanisë ashtu siç është, ajo e frymëzon atë në lartësi edhe më të mëdha dhe kjo është në KOSTT. E kuptoj përfundimisht se jam përgjegjës për suksesin ose dështimin e kompanisë dhe se punonjësit e KOSTT-it do të bëjnë atë që kërkohet për të më ndihmuar në realizimin e vizionit, misionit dhe objektivave strategjike të kompanisë. Gjithmonë kërkoj mendimin e bashkëpunëtorëve dhe kolegëve për të parë nëse të tjerët janë në të njëjtin drejtim në të cilin po shkoj. Kjo nënkupton që të gjithë luajnë një rol në suksesin tim dhe të ndërmarrjes.

Për mbi 13 vite nga themelimi i KOSTT, janë shënuar të arritura të shumta të kompanisë, madje nga zyrtarë të lartë vendorë dhe ndërkombëtar është cilësuar si një nga ndërmarrjet më të suksesshme në sektorin e energjisë jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon, cili është vizioni i juaj për KOSTT-in në 5 vitet e ardhshme?

Misioni ynë është që përmes operimit të sigurt dhe të besueshëm të Sistemit të Transmetimit si dhe operimit efikas të tregut të energjisë elektrike të krijojmë kushte për sigurinë e furnizimit me energji elektrike me qëllim që të mbështesim zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës si dhe mirëqenien shoqërore për qytetarët e vendit. KOSTT është një kompani e konsoliduar mirë dhe ne kemi punuar vazhdimisht në drejtim të krijimit të vlerës si për qytetarët e vendit ashtu edhe për aksionarin. Jemi përpjekur që në mënyrë të vazhdueshme t'i paraprijmë zhvillimit duke e ngritur nivelin e gatishmërisë së Rrjetit të Transmetimit për të akomoduar kapacitetet e reja gjeneruese, kemi punuar në drejtim të zhvillimit të tregut të energjisë si dhe nga aspekti i menaxhimit jemi angazhuar në ngritjen e cilësisë së punës dhe ekselencës së biznesit në përputhje me standarde të përcaktuara ndërkombëtare.



KOSTT, përfundimisht do të operojë si Zonë/Blok Rregullues brenda Evropës Kontinentale dhe atë duke filluar prej Prillit 2020, me idenë që të operojmë brenda Bllokut Rregullues OST – KOSTT, duke iu njohur KOSTT-it dhe Kosovës kufijtë energjetikë dhe njëkohësisht të kujdesshëm për obligimet e reja që na presin.

Operimi i pavarur brenda Bllokut Rregullues me OST (Shqipëri), menaxhimi i kongjestioneve dhe alokimi i kapaciteteve do realizohet brenda strukturës së këtij blloku dhe jo më nga EMS (Serbi), ku edhe të hyrat nga këto aktivitete do të mbledhen nga blloku/ KOSTT-i si dhe Linja 400 kV do të lëshohet në operim të rregullt, që është edhe parakusht për Bashkimin e Tregjeve Kosovë – Shqipëri një ditë para (day-ahead) dhe brenda ditës (intra-day). Po ashtu KOSTT do të jetë edhe aksionar në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (APEX) si dhe e integruar në RSC (Regional Security Coordination/Koordinimi i Sigurisë Regjionale) dhe RBM (Regional Balancing Market/Tregu Balancues Regjional)

Po sfidat me të cilat po përballët KOSTT sidomos në rrafshin ndërkombëtar, më konkretisht me njohjen ndërkombëtare si operator i pavarur i Sistemit Transmetues të Kosovës? Ju keni qenë shumë aktiv dhe shtytës për të lëvizur gjërat në këtë drejtim së fundi, jeni optimist?

Siç tashmë e dini dhe ju, KOSTT që nga themelimi në vitin 2006 është përballur me këtë sfidë dhe përkundër angazhimeve të vazhdueshme për zgjidhjen e çështjes KOSTT vazhdonte të mbetej në një limbo. Por, ne ishim të vendosur se gjërat duhej lëvizur dhe në vazhdimësi të sensibilizimit të situatës së krijuar, me mbështetjen edhe të institucioneve shtetërore dhe të miqve tanë ndërkombëtarë: Ambasada Amerikane, Ambasada Gjermane, USAID, KfW, kompanive homologe dhe miqve tjerë ndërkombëtarë në mes të këtij viti, në mbledhjen e 52-të të RGCE/ENTSO-E (Grupi Regjional i Evropës Kontinentale) u arrit që të votohet me 98.06 % PRO zhblokimit të procesit dhe bërjes së KOSTT zonë/blok rregullues i pavarur brenda zonës sinkrone të Evropës Kontinentale jo më larg se data 14 prill 2020. Kjo do të realizohet përmes një Marrëveshje të re të Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, ashtu siç e thash më lartë .

Prej se keni marrë nën udhëheqje KOSTT-in, sigurisht që keni pasur angazhime të shumta në drejtim të menaxhimit efektiv të kompanisë si dhe jeni përballur edhe me sfida dhe nevojë për vendimarrje strategjike. Çfarë mund të na thuani për vitin tuaj parë në drejtimin e KOSTT?



Edhe përkundër problemeve dhe sfidave, bashkë me kolegët dhe bashkëpunëtorët e afërt, kemi arritur që imazhin e KOSTT-it në arenën ndërkombëtare të përmirësojmë dhe ta ngritim edhe më lartë, si para ENTSO-E ashtu edhe para Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, me çka kjo e fundit e ka dhënë edhe opinionin pozitiv rreth Certifikimit të KOSTT-it, me ç' rast Zyra e Rregullatorit të Energjisë edhe ka lëshuar vendimin final.

Arritjet kryesore, që do i kisha përmendur janë:

- Përmirësimi dhe avancimi i raporteve ndër njerëzore dhe ndër kolegiale brenda kompanisë;
- Përmirësimi dhe avancimi i raporteve me akterët e sektorit të energjisë: ZRRE, KEK, KEDS, KESCO, palët tregtare dhe investitorët e ndryshëm në Burimet e Ripërtëritshme;
- Përmirësimi dhe avancimi i raporteve me institucionet shtetërore: Parlament, Qeveri dhe Presidencë;
- Përmirësimi dhe avancimi i raporteve me institucionet relevante ndërkombëtare në Kosovë: Ambasada Amerikane, Gjermane, Britanike, Zvicerane, USAID, KfW, BERZH etj;

- Riorganizimi në një periudhë të shkurtër në tërë kompaninë;
- Promovimi i më se 26 kuadrove profesionale në pozita menaxheriale, të gjeneratës së re dhe të mesme, duke marr për bazë edhe barazinë gjinore;
- Rivlerësimi dhe nivelimi i pagave;
- Operimi dhe Menaxhimi i sigurtë i Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike të Kosovës;
- Zhvillimi i infrastrukturës së rrjetit transmetues, përmes investimeve kapitale,
- Operimi dhe Menaxhimi i sigurtë i Tregut të Energjisë Elektrike;
- Mos dëmtimi dhe ruajtja e procesit politik, në kontekst të devijimeve elektrike ndaj interkoneksionit evropian, ku shkaktar është konsumi i pjesës veriore të Kosovës, gjegjësisht mospagesa e asaj energjie elektrike nga konsumatorët e asaj pjese të Kosovës
- Edhe shumë arritje dhe rezultate tjera.



Sfidë goxha e rëndë është zbatimi i Ligjit të Pagave në Sektorin Publik, prej 01 dhjetor 2019. Me vendim të posaçëm është formuar Komsioni për Vlerësimin e Koeficientëve për Paga, për secilin punonjës të KOSTT-it, marr për bazë funksionet dhe kriteret: të edukimit, eksperiencës, vendimmarrjes, kompleksitetit, përgjegjësisë, etj. Komisioni ka kryer detyrën e vet me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë.

Kategorizimi i pagave sipas koeficienteve dhe zbatimi me Vendim të Përkohshëm të ligjit për paga nuk paragjykon se KOSTT është tërhequr nga vlerësimet për kushtetutshmërinë për përfshirjen e KOSTT në Ligjin e Pagave në Sektorin Publik dhe angazhimin e mëtutjeshëm në shfrytëzim të të gjitha mekanizmave ligjorë për largim të KOSTT-it nga Ligji për Paga në Sektorin Publik. Në fund dëshiroj të cekim përkushtimin e menaxhmentit që efekti i ligjit të pagave, sidomos të stafi me paga tarifore, të jetë minimal.

Edhe përkundër të gjitha atyre problemeve, sfidave dhe pengesave, dua të përçoj mesazhin se asnjëherë nuk do të dorëzohem para asnjë pengese, problemi dhe sfide, pa marr parasysh nga kush vjen, me qëllim që KOSTT-i të avancojë edhe më shumë si në arenën ndërkombëtare, duke u bërë Zonë/ Bllok Rregullues i pavarur në Evropën Kontinentale si dhe anëtar në familjen ENTSO-E. Jam krenar me angazhimin dhe punën, që kam bërë bashkë me stafin, kolegët dhe bashkëpunëtorët e mi!

Një nga prioritetet tuaja është edhe avansimi i proceseve në drejtim të krijimit të tregut të përbashkët Kosovë-Shqipëri përfshirë dhe operacionalizimi i Bursës Shqiptare të energjisë (APEX). Si qëndrojnë proceset në këtë drejtim?

Siç është tashmë e ditur, ne po punojmë në drejtim të finalizimit të procesit të bashkimit të tregut të energjisë elektrike Kosovë-Shqipëri ku të dyja vendet janë duke bërë reforma në tregjet e tyre, të cilat do të mundësojnë operimin e tregut një ditë para dhe gjatë ditës.

Gjithashtu, sa i përket operacionalizimit të Bursës Shqiptare të energjisë (APEX), sipas planit të definuar të veprimeve, Këshilli i Ministrave të Shqipërisë ka nxjerr projektvendimin për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të bursës së energjisë elektrike, me të cilën është definuar edhe struktura e aksionarëve apo palëve tjera tregtare, sipas pjesëmarrjes së kapitalit. Aktualisht, ky proces është në fazën e pritjes së vendimit të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë për procedurat e përzgjedhjes së aksionarëve të kompanisë dhe në qoftë se çdo gjë shkon sipas parashikimeve, brenda 1 viti nga tani, do duhej të fillojë operimi i kompanisë ku pjesë e saj do të jetë edhe KOSTT. Për më tepër, siç e cekim edhe më herët jo më larg se deri në prill të vitit të ardhshëm KOSTT do të fillojë operimin si zonë/bllok rregullues i pavarur në kuadër të Evropës Kontinentale dhe nga ai moment do të

vendoset në operim edhe linja e re interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri.

Me finalizimin e këtyre proceseve do të përfitojnë konsumatorët e të dyja vendeve, meqenëse do të rritet siguria e furnizimit me energji elektrike, do të bëhet diversifikimi i burimeve të energjisë e cila do të ndikojë gjithashtu edhe në përmirësimin e kontrollit të sistemit energjetik dhe rezervave të sistemit, si dhe tërheqja e investimeve në kapacitete të reja gjeneruese me theks në burime të ripërtërishme të energjisë (BRE), janë vetëm disa nga përfitimet nga tregu i përbashkët.

Diçka për fund, ndonjë mesazh për punonjësit apo diç tjetër?

Duke iu dëshiruar shëndet, sukses dhe punë të mbarë uroj që të gjithë së bashku të vazhdojmë në ecjen përpara të KOSTT-it, pasi vetëm si kompani e suksesshme, financiarisht e qëndrueshme dhe profesionalisht e përgatitur do të jemi lider brenda vendit dhe akter i pakontestueshëm jashtë vendit në të gjithë mekanizmat në sektorin e energjisë elektrike.

Ambasadori i RF Gjermane z. Christian Heldt vizitoi Nënstacionin 400/110kV Peja 3



Gjatë muajit Maj, në nënstationin NS 400/110kV-Peja 3 Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M Shala me bashkëpunëtorë priti në takim delegacionin gjerman të kryesuar nga Ambasadori Gjerman në Kosovë Sh.T.z Christian Heldt, i shoqëruar nga znj. Anja Becky, Udhëheqëse e Departamentit për Zhvillim Ekonomik në Ambasadën Gjermane në Kosovë dhe përfaqësues të Bankës Gjermane për Zhvillim KfW z. René Eschemann, Drejtor i Zyrave për Kosovë dhe Maqedoni si dhe zv. Drejtoresha znj. Ganimete Huruglica. Gjatë takimit, Ambasadori Heldt dhe delegacioni gjerman u njoftuan më për së afërmi me rezultatet, sukseset dhe sfidat që po kalon KOSTT në arenën ndërkombëtare, me theks të posaçëm ato të bërjes së KOSTT Zonë/Blllok Rregullues brenda Evropës Kontinentale.

Ambasadori Heldt mbeti tejet i kënaqur me rezultatet e arritura të KOSTT, me ç'rast përgëzoi KOSTT-in për këto arritje dhe njëkohësisht u zotua në dhënien e përkrahjes në proceset nëpër të cilat po kalon dhe ato drejtë anëtarësimit në mekanizmat ndërkombëtare.

Me këtë rast Kryeshefi Ekzekutiv z. Shala falënderoi përzemërsisht Ambasadorin Heldt dhe përfaqësuesit e delegacionit për përkrahjen e pakursyer dhënë KOSTT-it në këtë dekadë, sidomos në periudhën e fundit.

Nënstacioni 400/110 kV Peja 3 ka qenë pjesë e paket projektit i cili u realizua në bashkëfinancim me Qeverinë Gjermane përmes Bankës për Zhvillim (KfW) në vitin 2009.

Inaugurohet Nënstacioni 110/10(20)kV Ilirida dhe linjat nëntokësore transmetuese 110 kV

Me datë 19 Qershor 2019 në praninë e delegacionit të lartë Qeveritar të Republikës së Kosovës, përfaqësuesve të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bankës Gjermane për Zhvillim KfW si dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare u inaugurua paket projekti “Ndërtimi i Nënstacionit 110/10(20)kV Ilirida dhe Linjave Nëntokësore Transmetuese 110 kV”.

Përfundimi i punimeve dhe lëshimi në punë i këtij nënstacioni i bashkë financuar me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në kuadër të projektit për Zhvillimin e Sistemit

Transmetues, dhe e ndërtuar me stabilimente të tensionit të lartë me izolim me gaz (Gas Insulated Switchgear – GIS), të cilat nga aspekti i sigurisë janë më të besueshme për operim me zero aksidente deri më tani dhe të përshtatshme për ambiente të banueshme në qytete dhe të cilat janë të më të përshtatshme për ambientin, do të ndikojë në rritjen e kapaciteteve transmetuese dhe transformuese, rritjen e sigurisë dhe kualitetit të furnizimit me energji elektrike për rajonin e Mitrovicës dhe gjithë Republikën e Kosovës, duke zvogëluar humbjet në transmision dhe zvogëlimin e energjisë së pa furnizuar si rezultat i eliminimit të fyteve të ngushta në rrjetin e shpërndarjes dhe mbështetje për zhvillimin ekonomik dhe industrial të rajonit të Mitrovicës.



Me këtë rast Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala në fjalën e tij të rastit theksoi “ Inaugurimi i këtij projekti vjen në vazhden e sukseseve tjera të KOSTT-it dhe përkushtimin e të gjithë punonjësve për arritjen e standardeve më të larta profesionale, të cilat kanë dhënë dhe po japin rezultate të prekshme për të gjithë konsumatorët e Kosovës. Deri më tani Mitrovica është furnizuar nga një nënstacioni i vjetër dhe jo i besueshëm, i cili është aset i kompleksit Trepça, ndërsa me ndërtimin dhe lëshimin në punë të Nënstacionit Ilirida po përmbushim kriterin e sigurisë së rrjetit transmetues respektivisht kriterit N-1, që mundëson funksionim stabil të sistemit transmetues si



dhe po kontribuojmë në përmirësimin e cilësisë së furnizimit për konsumatorët e Mitrovicës – jam i bindur se banorët e Mitrovicës do të vërejnë ndryshimin”.

Kryeministri i Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj duke e përgëzuar KOSTT-in dhe duke folur për rendësinë e ndërtimit të këtij nënstacioni i cili ndikon në rritjen e sigurisë së furnizimit të energjisë elektrike të qytetarëve të Mitrovicës theksoi “Sa mirë të bashkohemi në Mitrovicë për një vepër të tillë ekonomike në energji, kur jemi të vetëdijshëm sa vitale është energjia, jo vetëm për jetën ekonomike, por edhe për sigurinë. Kjo vepër që i dedikohet shërbimit me energji për konsumatorin, e rregullon gjendjen me energji për 50 vjetët që vijnë. Për të pasur stabilitet një vend duhet të investohet në energji”.

Në fjalën e tij Kryetari i Komunës së Mitrovicës z. Agim Bahtiri theksoi "Mitrovica ka pasur nevojë për paqe dhe stabilitet, të cilën e kemi ndërtuar së bashku me qytetarët dhe për këtë gjë jemi krenar. Falë stabilitetit kemi bërë që investitorët të kthehen të investojnë në Mitrovicë për arsye se puna e tyre tashmë është e sigurt dhe këtë e dëshmojnë projektet e shumta që janë realizuar në Mitrovicë. Ky nën-stacion është shumë i rëndësishëm për qytetarët e Mitrovicës, të cilët do furnizohen mjaftueshëm me energji elektrike, dhe projektet e tilla për qytetin e Mitrovicës po vazhdojnë edhe në këtë vit, ku do të kemi investime qindra milionëshe në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike

Ky projekt i cili kap vlerën prej 5.4 Milion Euro është bashkë financuar me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim përmes kredisë së butë komerciale në kohëzgjatje prej 12 viteve dhe është realizuar në 3 (tre) LOT-a nga kontraktuesit: Konzorciumi ABB Italy dhe ABB Kroaci; Konzorciumi Hyundai Heavy Industry (Bullgari) dhe Ballkan Petrol Energy (Kosovë) dhe Romelectro (Rumani) si dhe kompania konsulente AF Consult (Zvicër), të cilëve i jemi mirënjohës për punën e bërë.

Në përmbyllje Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Shala gjithashtu falënderoj Ministrinë e Financave, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Komunën e Mitrovicës për mbështetjen e ofruar gjatë implementimit të këtij projekti dhe njëkohësisht përgëzoj stafin e KOSTT-it për angazhimin dhe punën e bërë gjatë fazës së përgatitjes së projektit dhe implementimit të tij.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë publikoi Opinionin mbi vendimin preliminar të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë mbi certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Energjisë – KOSTT sh.a.

Me datë 5 Shkurt 2019, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore publikoi Opinionin mbi certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Kosovës (KOSTT), në kuadër të Pakos së Tretë të Energjisë. Ky Opinion mbështet certifikimin e KOSTT në përputhje me Vendimin preliminar të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës (ZRRE), me disa vërejtje. Sekretariati gjithashtu i bëri thirrje ZRRE-së që të monitoroj pajtueshmërinë e KOSTT me dispozitat e shturjes (unbudling). Në veçanti, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë kërkoi nga ZRRE që të vlerësoj më tutje dhe të elaboroj mbi procesin e emërimit të anëtarëve në Bordin e Drejtorëve të KOSTT nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe të siguroj që ai person të mos jetë anëtar i bordit të kompanive tjera që merret me prodhimin e energjisë elektrike në vend. Gjithashtu, duhet të krijohet një kornizë për të siguruar që KOSTT funksionon në mënyrë të pavarur nga Qeveria, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Financave (p.sh. rregullat mbi shkëmbimin e informatave, raportimin dhe vendimmarrjen në lidhje me asetet e transmisionit).

Gjithashtu SKE, ka kërkuar nga ZRRE zbatimin e një programi të pajtueshmërisë dhe të bëjë emërimin e nje zyrtari për pajtueshmëri me kërkesat ligjore si dhe të siguroj raportimet mbi marrëdhëniet mes dy organeve publike që kontrollojnë KOSTT-in (që kontrollohet nga Kuvendi) dhe operatorin shtetëror për gjenerim, përkatësisht Korporatës Energjike të Kosovës (KEK)/hidrocentralit Ujmani (që kontrollohet nga Qeveria, përmes Ministrisë për Zhvillim Ekonomik).

Siç edhe kërkohet në Nenin 10 të Direktivës 2009/72/KE dhe Nenin 3 të Rregullores (KE) 714/2009, ZRRE-ja duhet të miratoj një vendim përfundimtar për certifikim, duke marr parasysh opinionin e Sekretariatit.

KOSTT edhe një hap para, drejt anëtarësimit në ENTSO-E

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në mbledhjen e mbajtur me 15 shkurt 2019, ka marrë vendimin final për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST – KOSTT), pas nxjerrjes së Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (SKE) në vendimin preliminar të Bordit të ZRRE të datës 24 shtator 2018, me të cilin Bordi kishte vendosur se OST-KOSTT përmbushë kriteret për të certifikuar si Operator i pavarur i Transmetimit të energjisë elektrike. Me Vendimin final për Certifikimin e OST-KOSTT, i cili mbështetet edhe në Opinionin e SKE, ZRRE-ja ka konfirmuar se ka ndarje të mjaftueshme të kontrollit mbi OST-në, prodhimin dhe/apo furnizimin e energjisë elektrike dhe që KOSTT vepron në përputhje me dispozitat e shturjes, të përcaktuara me kapitujt IV dhe V të Direktivës 2009/72/EC1, kapituj këta të transpozuar në legjislacionin e Kosovës nëpërmjet nenit 11 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

Certifikimi i KOSTT si OST rrjedh si obligim i Pakos së Tretë të Bashkimit Evropian për Energji (Rregullorja (EC) 714/2009 dhe Direktiva 72/2009/EC) të cilat janë transpozuar në Ligjin për energjinë elektrike të Republikës së Kosovës, Neni 10 deri 16, të cilat përcaktojnë një varg kushtesh për funksionet bazë dhe pavarësinë e OST, siç janë pronësia e asetëve të transmisionit, përmbushja e funksioneve të OST (mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të transmisionit, operimi i sistemit në pajtim me kërkesat e Bashkimit Evropian, menaxhimi i kapaciteteve interkonektive, etj), pavarësia financiare, pavarësia menaxheriale, resurset e mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të operuar sistemin e transmisionit.

Rëndësi e certifikimit të KOSTT si OST dhe njohja e këtij certifikimi nga Sekretariati si institucion simotër i Komisionit Evropian, është qenësor për njohjen e KOSTT si OST nga ENTSO-E si një ndër parakushtet themelore për anëtarësim në ENTSO-E, dhe institucionet tjera evropiane, dhe do t'i mundësonte KOSTT operimin e pavarur nga Serbia dhe se njohja e kapaciteteve teknike, operative, financiare, menaxheriale, do të eliminon pretendimet e Serbisë që KOSTT nuk ka kapacitete për të operuar dhe menaxhuar sistemin elektroenergetik të Kosovës.

Menaxhmenti i KOSTT, me këtë rast falënderoi dhe përgëzoi gjithë stafin e KOSTT të angazhuar në këtë aktivitet, me përkushtimin e vazhdueshëm në ngritjen e cilësisë së punës, përmbushjes së kërkesave ligjore, standardeve të sigurisë së operimit të sistemit në përputhje me udhëzimet e ENTSO-E dhe përmbushjen e kërkesave rregullative në drejtim të anëtarësimit të plotë në ENTSO-E.



KOSTT realizon vizitë në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Maqedonisë së Veriut-MEPSO



Me qëllim të bashkëpunimit rajonal me operatorët e sistemeve transmetuese, menaxhmenti i lartë i KOSTT i udhëhequr nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Ilir M. Shala, së bashku me bashkëpunëtor në muajin shkurt 2019 realizuan një vizitë në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Maqedonisë së Veriut-MEPSO.

Në takim të cili u realizua me përfaqësuesit e lartë të kompanisë homologe MEPSO në krye me Drejtorin e Përgjithshëm z. Sasho Vasilevski dhe Zëvendës Drejtorin e Përgjithshëm z.

Bilen Saliji u diskutua për vazhdimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në drejtim të sigurisë së operimit të sistemit të transmisionit të të dy vendeve si dhe mbështetjes së KOSTT nga MEPSO për t'u bërë Zonë/Bllok Kontrollues i pavarur në Evropën Kontinentale përmes zbatimit të Marrëveshjes për Kyçje me ENSTO-E ose përmes dokumentit SAFA (Marrëveshja Kornizë e Zonës Sinkrone)

Në përmbyllje, z. Shala falënderoi homologët në MEPSO për bashkëpunim dhe vlerësoi gatishmërinë për përkrahjen e KOSTT-it për tejkalimin e sfidave aktuale në integrim në mekanizmat ndërkombëtar.

KOSTT Kompania e parë publike, e cila në drejtim të masave të sigurisë për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera realizon simulim/ushtrim të gjendjes emergjente



Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a, në drejtim të masave të sigurisë, me mbështetjen e Policisë së Republikës së Kosovës, Brigadës për Kërkim Shpëtim dhe Zjarrfikje në Komunën e Prishtinës dhe Urgjencës së Prishtinës, gjatë muajit Mars realizoi një Simulim/Ushtrim të gjendjes emergjente në përputhje me Ligjin Nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në Selinë Qendrore të KOSTT.

Parandalimi i fatkeqësive natyrore, teknologjike dhe fatkeqësive të shkaktuara nga faktori njeri si dhe gatishmëria për të ndërmarrë veprimet e duhura në raste emergjente, gradualisht janë bërë detyrë kryesore, pjesë integrale e strategjisë dhe planeve për zhvillimin e sistemit të reagimit emergjent në KOSTT dhe si rezultat brenda katër minuta e katërbëdhjetë sekondave është boshatisur e tërë ndërtesa, brenda dy minuta e dymbëdhjetë sekondave ka arritur në vend ngjarje Policia e Kosovës, brenda dy minuta e njëzet e pesë sekondave kanë arritur Urgjenca, brenda katër minuta e katër dhjetë e shtatë sekondave kanë arritur në vendin e ngjarjes Zjarrfikësit, dhe brenda nëntëmbëdhjetë minutave është

evakuuar punëtori i alivanosur (simulim).

“Me këtë, KOSTT u bë kompania e parë publike në Kosovë që ka realizuar një ushtrim të tillë, dhe si çdo herë po vazhdojmë të sjellim praktikën më të mira konform standardeve globale, me ç’ rast përfunduar suksesshëm evakuimin e ndërtesës qendrore të KOSTT në kohë të duhur.”, theksoi Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT, z. Ilir M. Shala. Ai tutje falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin në këtë simulim/ushtim, i cili për herë të parë u realizua në një kompani publike me mbështetjen e plotë të Policisë së Kosovës, Brigadës për Kërkim/Shpëtim dhe Zjarrfikje në Komunën e Prishtinës si dhe Urgjencën. Gjithashtu falënderoi të gjithë punonjësit e KOSTT, të cilët treguan gatishmëri dhe bashkëpunim dhe theksoi “tashmë kemi një indikatorë që ne si KOSTT jemi ende më të gatshëm të veprojmë në raste emergjente si dhe po përmbushim obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera”.



KOSTT pjesë e iniciativës Mbjell një Pemë/Plant a Tree Challenge Kosovo

Në kuadër të fushatës për mbjelljen e një peme, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT pranoi me kënaqësi sfidën nga Drejtori Rajonal i Bankës Gjermane për Zhvillim KfW, z. René Eschemann ku me 15 prill 2019 në kopshtin e ndërtesës qendrore të KOSTT mbolli një pemë lajthie.

Në këtë vazhdë, z. Shala duke iu uruar suksese, nominoi Drejtorin Menaxhues të KEK z, Njazi Thaqi, Drejtorin Menaxhues të KEDS z. Alper Erbas dhe u.d Kryesues i Bordit të ZRRE z. Arsim Janova për sfidën e radhës!



KOSTT vazhdon të kontribuoj në mirëqenien e fëmijëve të Kosovës

Me përkushtimin për të kontribuar në mirëqenien dhe shëndetin e fëmijëve të Kosovës, KOSTT sh.a vazhdon të promovojë praktikën më të mira të përgjegjësisë shoqërore korporative, duke kontribuar në mirëqenien dhe shëndetin e fëmijëve të Kosovës.

KOSTT, edhe këtë radhë, buxhetin e dedikuar për dhurata korporative, ka vendosur ta dhurojë në përkrahje të mirëqenies dhe shëndetit të fëmijëve:

- të diagnostikuar me kancer, që trajtohen në Klinikën Pediatrike Onkologjike në QKUK, përmes fondacionit “Care for Kosovo Kids” (CfKK/FKfK)
- fëmijëve me autizëm përmes Shoqatës Autizmi Flet, si dhe
- fëmijëve të porsalindur me probleme shëndetësore, që trajtohen në Klinikën e Neonatologjisë në

Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, përmes fondacionit “Action for Mothers and Children” (AMC).



Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala u shpreh: “Me shpresë që po i dhurojmë buzëqeshje fëmijëve dhe familjeve të tyre, duke ngritur vetëdijesimin e shoqërisë për fëmijët e prekur me autizëm, ne po kontribuojmë në fuqizimin e tyre si dhe duke mundësuar qoftë edhe në diagnostikimin e vetëm një fëmije të sëmurë nga kanceri apo dalë në ndihmë fëmijëve të lindur para kohe, ne e përmbillëm vitin 2018 të përmbushur me shumë suksese”.

Kryeministri i Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj priti në takim Kryeshefin Ekzekutiv të KOSTT z. Ilir M. Shala



Më 17 Janar 2019, në selinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kryeministri i vendit z. Ramush Haradinaj priti në takim Kryeshefin Ekzekutiv të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut sh.a – KOSTT, z. Ilir M. Shala, me ç’rast diskutuan për stabilitetin energjetik në vend.

Në takim, gjithashtu u diskutua në lidhje me sfidat me të cilat po përballon KOSTT si pasojë e mos implementimit të Marrëveshjes për Kyçje me ENTSO-E si dhe sfidat tjera.

Kryeministri Haradinaj theksoi se Qeveria e Kosovës do të mbështesë veprimet e këtij mekanizmi dhe pavarësinë e tij,

në funksion të mbarëvajtjes së punëve dhe operimin e sigurtë të sistemit transmetues.

z. Shala, me këtë rast falënderoi Kryeministrin Haradinaj dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës për përkrahjen e vazhdueshme në mbarëvajtjen e operimit të Sistemit Transmetues, me theks të posaçëm në bërjen e KOSTT Zonë/Blok Rregullës drejtë anëtarësimit në ENTSO-E.

KOSTT vazhdon me vizitat në kërkim të përkrahjes së të bërit Zonë/Blok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale

Në vazhdën e takimeve në funksion të përkrahjes së të bërit së KOSTT-it Zonë/Blok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale dhe bashkëpunimit rajonal me operatorët e sistemeve transmetuese, menaxhmenti i lartë i KOSTT i udhëhequr nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Ilir M. Shala, së bashku me bashkëpunëtorë në muajin mars 2019 realizuan vizitë në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Shqipërisë. Në takimin, i cili u realizua me përfaqësuesit e lartë të kompanisë homologe nga Shqipëria në krye me

Administratorin z. Skerdi Drenova, u diskutua po ashtu edhe për vazhdimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në drejtim të sigurisë së operimit të sistemit të transmisionit të dy vendeve dhe progresit në krijimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike si dhe procesit të themelimit të bursës shqiptare të energjisë (APEX), ku KOSTT do të jetë aksionar dhe në veçanti u diskutua rreth sfidave në drejtim të implementimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT-ENTSO-E, me të cilën është e ndërlidhur edhe vënia në operim e linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri.

Gjithashtu, u diskutua mbi shkëmbimin efikas të infrastrukturës në dispozicion të fibrave optike duke pasur parasysh që KOSTT është një nga OST-të e para nga Ballkani Perëndimorë që tashmë ka filluar me ofrimin e shërbimeve për shfrytëzimin me qira të rrjetës së lirë/të pashfrytëzuar të fibrave optik (dark fiber/të pa-ndriçuar) si dhe masat e përbashkëta në drejtim të mbrojtjes kibernetike (cyber security) të dy sistemeve transmetuese.

Në përmbyllje, z. Shala falënderoi për zemërsisht z. Drenova për gatishmërinë për bashkëpunim dhe vlerësoi lartë zotimin e tij për përkrahjen e KOSTT-it për t'u bërë Zonë/Blok Rregullues i pavarur në Evropën Kontinentale, qoftë përmes Marrëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E apo përmes nënshkrimit të dokumentit SAFA (Marrëveshja Kornizë e Zonës Sinkrone).



KOSTT pjesë e kampanjës vjetore të Ditës Ndërkombëtare të Gruas/IWD 2019 përmes iniciativës Balance for Better/Balanco për më mirë

Me përkushtimin për të arritur dhe promovuar barazi gjinore brenda kompanisë me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes profesionale të grave në rolet udhëheqëse dhe vendimmarrëse dhe në përpjekje të krijimit të një fuqie punëtore më të balancuar në aspektin gjinor, me mbështetjen e partnerëve tanë përmes Engendering Utilities (program i USAID) implementuar nga Tetra Tech, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala tashmë ka iniciuar programin për leadership 50/50 në KOSTT, i cili ka për synim pjesëmarrjen në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe udhëheqëse të punonjësve të përzgjedhur në përmbushje të zotimeve në balancimin e barazisë gjinore në kompani. Prej 10 anëtarë të stafit, 5 janë përzgjedhur të jenë të gjinisë femërore dhe 5 sish të gjinisë mashkullore.

Në vigjilje të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, dhe në kuadër të iniciativës globale Balance for Better, me moton “Një botë e balancuar është një botë më e mirë”, programi Engendering Utilities USAID/Tetra Tech promovoi iniciativën e KOSTT për leadership 50/50 në kompani, në kampanjën për vetëdijësim të balancimit gjinor duke përçuar mesazh që përqendrohet në mënyrat e krijimit të një shoqërie më të balancuar gjinore.





Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it, z.Illir M.Shala ndër të tjera theksoi se mbështet fuqimisht mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat në KOSTT. “Si udhëheqës i KOSTT-it e di se kjo është mënyra më e mirë për të ecur përpara, për të zhvilluar kompaninë dhe vendin. Ne jemi ndërmarrja e vetme publike në Kosovë dhe rajon, që këtë program na ka besuar Qeveria Amerikane përmes USAID, me ç’rast edhe shfrytëzojmë rastin që përzemërisht t’i falënderohemi”.

KOSTT Inauguron edhe një projekt madhor- Nënstacioni 220/10(20)kV Drenasi dhe linja e dyfishtë transmetuese 220kV



Me datë 27 Qershor 2019, në praninë e personaliteteve të shumta të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, përfaqësuesve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, përfaqësuesve të Ambasadës Gjermane, u inaugurua paket projekti “Ndërtimi i Nënstacionit 220/10(20)kV Drenasi dhe Linjës së Dyfishtë Transmetuese 220kV “.

Inaugurimi i këtij projekti vjen në vazhden e sukseseve tjera të KOSTT-it dhe përkushtimin e të gjithë punonjësve për arritjen e standardeve më të larta profesionale, të cilat kanë dhënë dhe po japin rezultate të prekshme për të gjithë konsumatorët e Kosovës. Deri më tani, Drenasi është furnizuar nga një nënstation i tej ngarkuar 35kV, i cili është aset i KEDS-it, ndërsa me ndërtimin dhe lëshimin në punë të Nënstacionit 220/10(20) kV Drenasi po kontribuojmë në përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e Drenasit.

Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala në fjalën e tij të rastit theksoi “ngjarja e sotme shënon edhe një zhvillim dhe sukses madhor për KOSTT-in, Rajonin e Drenasit dhe Republikën e Kosovës, paket projekt ky shumë i rëndësishëm për Sistemin Elektroenergetik të Republikës së Kosovës.

Përfundimi i punimeve dhe lëshimi në punë i këtij nënstationi të bashkë financuar me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në kuadër të projektit për Zhvillimin e Sistemit Transmetues, do të ndikojë në rritjen e kapaciteteve transmetuese dhe transformuese, rritjen e sigurisë dhe kualitetit të furnizimit me energji elektrike për rajonin e Drenasit dhe gjithë Republikën e Kosovës, duke zvogëluar humbjet në transmision, zvogëlimin e energjisë së pa furnizuar si rezultat i eliminimit të fyteve të ngushta në rretin e shpërndarjes dhe duke krijuar mbështetje për zhvillimin ekonomik dhe industrial të rajonit të Drenasit. Nënstacioni i Drenasit është ndërtuar me stabilimente të tensionit të lartë 220kV me izolim me gaz (Gas Insulated Switchgear – GIS), që janë fjala e fundit e teknologjisë të cilat nga as-

pekti i sigurisë janë më të besueshme për operim me zero aksidente deri më tani në botë. Këto paisje janë të përshtatshme për ambiente të banueshme siç janë qytetet si dhe nuk e ndotin mjedisin.”

Përfaqësuesi i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim z. Bekim Muarremi duke e përgëzuar KOSTT-in dhe menaxhmentin e KOSTT-it si një bashkëpunëtor shembullor gjatë implementimit të këtij projekti, uroi sukses dhe bashkëpunim me BERZH në të gjitha sferat si dhe projektet e ardhshme të KOSTT edhe në të ardhmen.

Në fjalën e tij Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci theksoi ”Jam shumë i lumtur që Nën-stacioni në Drenas po përurohet, projekt ky i filluar në vitin 2017 nga ardhja ime në krye të Drenasit dhe që atëherë kam premtuar menaxhmentin e KOSTT-it që asnjë pengesë gjatë implementimit të këtij projekti madhor për Drenasin nuk do të ketë dhe prandaj edhe në afat rekord kemi përfunduar punimet dhe qytetarët e Drenasit dhe bizneset do të gëzojnë frytet e saj”.

Përfaqësuesi i kompanisë kontraktuese ABB Italy, z. Rinaldo Pagani theksoi se ABB është shumë e lumtur të mbështesë zhvillimin e Republikës së Kosovës me teknologjinë më të mirë dhe më të avancuar të kompanisë ABB, por sot është dita të festojmë punën e të gjithë punonjësve të angazhuar nga Italia, Kroacia, Turqia, Shqipëria dhe Kosova si dhe të gjithë nën-kontraktorët të cilët morën pjesë në implementimin e këtij projekti për dy vite. Përkundër udhëtimit sfidues gjatë implementimit të punimeve sot është dita të admirojmë atë që kemi arritur dhe se kompania ABB është e gatshme të bashkëpunojë me KOSTT dhe Republikën e Kosovës edhe në të ardhmen.

Ky projekt i cili kap vlerën prej 6.8 Milion Euro është bashkë financuar me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim përmes kredisë së butë komerciale në kohëzgjatje prej 12 viteve, dhe është realizuar në 3 (tre) LOT-e nga kontraktuesit: Konzorciumi ABB Italy dhe ABB Kroaci; Konzorciumi Hyundai Heavy Industry (Bullgari) dhe Ballkan Petrol Energy (Kosovë) dhe Romelectro (Rumani) si dhe kompania konsulente AF Consult (Zvicër), të cilëve i jemi mirënjohës për punën e bërë.

Në përmbyllje Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Shala, falënderoi Ministrinë e Financave, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Komunën e Drenasit për mbështetjen e ofruar gjatë implementimit të këtij projekti dhe njëkohësisht përgëzoi stafin e KOSTT-it për angazhimin dhe punën e bërë gjatë fazës së përgatitjes së projektit dhe implementimit të tij.



KOSTT realizon vizitë në OST-në Bullgare në funksion të përkrahjes për t'u bërë Zonë/Blok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale



Të bërit Zonë/Blok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale dhe bashkëpunimi rajonal me operatorët e sistemeve transmetuese, vazhdon të jetë kryefjala e takimeve të realizuara nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT z. Ilir M. Shala, me ç'rast në këtë vazhdë realizoi vizitë në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Bullgarisë- ESO.

Në takimin e radhës, i cili u realizua në Sofje të Bullgarisë me 13 Mars 2019, me përfaqësuesit e lartë të kompanisë homologe nga ESO në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z. Angelin Tsachev dhe bashkëpunëtorët e tij, u diskutua për statusin e Marrëveshjes ekzistuese të Kyçjes KOSTT-ENTSOE dhe SAFA-n e ardhshme (Marrëveshja Kornizë e Zonës Sinkronike).

Me këtë rast, z. Shala falënderoi përzemërsisht z. Tsachev për mikpritjen dhe vlerësoi gatishmërinë për bashkëpunim dhe mbështetjen dhënë KOSTT-it për integrimin në iniciativat rajonale dhe evropiane të tregut të energjisë elektrike dhe integrimet tjera evropiane.

Vazhdojnë takimet e menaxhmentit të KOSTT-it në kërkim të mbështetjes për t'u bërë Zonë/Blok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale



Në drejtim të avancimit të mëtutjeshëm të bashkëpunimit rajonal me operatorët e sistemeve transmetuese si dhe gjetjen e përkrahjes për KOSTT-in për t'u bërë Zonë/Blok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale, Kryeshefi i KOSTT, z. Ilir M. Shala me bashkëpunëtorë, realizoi vizitë në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Kroacisë-HOPS.

Në takimin i cili u realizua në Zagreb më 18 Mars 2019, me përfaqësuesit e lartë të kompanisë homologe nga HOPS në krye me Kryetarin e Bordit Drejtues z. Mario Gudelj dhe bashkëpunëtorët e tij, u diskutua për statusin e Marrëveshjes ekzistuese të Kyçjes KOSTT-ENTSOE dhe SAFA-n e ardhshme (Marrëveshja Kornizë e Zonës Sinkronike).

Me këtë rast, z. Shala falënderoi përzemërsisht z. Mario Gudelj për mikpritjen dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe mbështetjen dhënë KOSTT-it për integrimin në iniciativat rajonale dhe evropiane të tregut të energjisë elektrike dhe integrimet tjera evropiane.

CGES e Malit të Zi, mbështet KOSTT-in në drejtim të të bërit Zonë/Blok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale

Gjatë muajit Prill 2019 Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT, z. Ilir M. Shala me bashkëpunëtorë qëndroi në Mal të Zi ku në kuadër të takimeve rajonale në gjetjen e përkrahjes për KOSTT për t'u bërë Zonë/Blok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale, si dhe bashkëpunimit rajonal me operatorët e sistemeve transmetuese, kësaj radhe realizoi vizitë në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Malit të Zi-CGES.

Në takimin e realizuar me përfaqësuesit e lartë të kompanisë homologe nga Mali i Zi në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z. Dragan Kujović dhe bashkëpunëtorët e tij, u diskutua për statusin e Marrëveshjes ekzistuese të Kyçjes KOSTT-ENTSOE dhe SAFA-n e ardhshme (Marrëveshja Kornizë e Zonës Sinkronike).

Me këtë rast, z. Shala falënderoi përzemërsisht z. Dragan Kujović për mikpritjen dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe mbështetjen dhënë KOSTT-it për integrimin në iniciativat rajonale dhe evropiane të tregut të energjisë elektrike dhe integrimet tjera evropiane.



Kosova dhe Shqipëria të përkushtuara për avancimin e bashkëpunimit në mes të dy sistemeve energjetike

Menaxhmenti i lartë i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z. Ilir M. Shala, pritën në takim Administratorin e Përgjithshëm të Operatorit të Sistemit Transmetues të energjisë elektrike në Shqipëri - OST z. Skerdi Drenova, ku diskutuan për çështje me interes për Sistemet Transmetuese të energjisë elektrike të Kosovës dhe Shqipërisë.

Tema të veçanta për të cilat biseduan të dy delegacionet homologe ishin bashkëpunimi në proceset e integritimeve regjionale dhe evropiane si dhe bashkëpunimi në drejtim të realizimit të projekteve të përbashkëta të cilat janë në funksion të integritimit të tregjeve të energjisë si dhe sigurisë së furnizimit për konsumatorët e energjisë elektrike të të dyja vendeve.

Përveç tjerash, u diskutuan edhe sfidat nëpër të cilat po kalon KOSTT drejt operimit të pavarur në Evropën Kontinentale si Zonë/Blok Rregullues, ku kontributi dhe përkrahja e OST të Shqipërisë në këtë drejtim nuk ka munguar asnjëherë.

Në përfundim, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Shala falënderoi përzemërsisht z. Skerdi Drenova dhe OST për përkrahjen e ofruar.



U mbajt takimi i parë i Grupit Punues për Ballkanin në kuadër të Iniciativës për Sigurinë Kibernetike (UCSI), pjesë e së cilës është edhe KOSTT

Në funksion të ngritjes së sigurisë kibernetike për të nxitur zhvillimin dhe praktikën më të mira të menaxhimit të shërbimeve dhe vendosjen e teknologjive të reja të rrjetit për të ndihmuar ndërmarrjet energjetike të vendet e regjionit të Detit të Zi dhe Ballkanit në zhvillimin e një mbrojtjeje të fuqishme ndaj kërcënimeve kibernetike, në Budapest me 6 dhe 7 Maj 2019, u mbajt takimi i parë i Grupit Punues për Ballkanin në kuadër të Iniciativës për Sigurinë Kibernetike të Shërbimeve të energjisë pjesë e së cilës ishte edhe Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala me bashkëpunëtor.

Me moton Siguria e Rrjeteve: Fuqia e Besueshme për Zhvillimin Ekonomik - Këtë javë Programi i Agjencionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) i implementuar nga Asociacioni i SHBA-ve për Energji (USEA) për Teknologjinë e Energjisë dhe Programin e Qeverisjes lansoi Iniciativën e Sigurisë Kibernetike (UCSI) për të ndihmuar operatorët e sistemit të transmetimit në Evropën juglindore të zbulojnë kërcënimet kibernetike, të forcojnë mbrojtjen e tyre dhe të bëhen më efikas pas sulmeve kibernetike.

Anëtarët zhvilluan një Model të maturitetit të aftësive në fushën e sigurisë kibernetike (C2M2), filluan zhvillimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut të Sigurisë Kibernetike të Ballkanit dhe u diskutua me shitësit e programeve Amerikane, duke zbatuar aplikacionet për sigurinë kibernetike.

Iniciativa për sigurinë kibernetike është një element programor i Iniciativës së USAID-it për sigurinë kibernetike në Sektorin e Energjisë. UCSI u krijua nga operatorët e sistemit të transmetimit dhe të gazit natyror si dhe kompanitë e shpërndarjes në rajonin e Evropës dhe Euroazisë si përgjigje ndaj sulmeve kibernetike gjithnjë e më virulente në rrjetin elektrik në këto vende.

Ngjarja mbledhi operatorët e sistemit të transmissioinit (OST-t) nga Evropa, rajoni i Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja & Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi) dhe më gjerë, pjesë e së cilës ishte edhe delegacioni i Operatorit të Sistemit, Transmissioinit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës KOSTT sh.a, i kryesuar nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Ilir M. Shala.

Gjatë dy viteve të fundit, sulmet mbi infrastrukturën kritike janë rritur tej mase, dhe pasojat e mundshme janë shumë me ndikim dhe rëndësi në kompani dhe si rezultat, KOSTT po e trajton si temë shumë të veçantë sigurinë kibernetike në veprimtarinë e saj.

KOSTT në planin e vet afatshkurtër të zhvillimit e ka si qëllim final Certifikimin edhe me standardin ndërkombëtar ISO/IEC 27001 dhe standarde tjera, që ndërlidhen me menaxhimin dhe vlerësimin e riskut dhe të sigurisë së informacionit.

Siguria Kibernetike në fushën e Energjisë



Arianit Berisha

Menaxher për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit

Siguria kibernetike ka një rëndësi të veçantë në të gjithë sektorët industrial dhe komercial, por në sektorin energjetik duhet ti japim rëndësi edhe më të madhe, për shkak të vetë rrethanave gjeopolitike si dhe rëndësisë së shërbimit të furnizimit me energji elektrike për të gjithë sektorët e tjerë dhe mirëqenien e qytetarëve në përgjithësi.

Për këtë arsye, i gjithë sektori i TIK duhet të fillojë të mendojë ndryshe për të gjitha mënyrat e mundshme të përdorimit të teknologjisë informative,

pajisjeve harduerike, sistemeve logjike dhe softuerike, duke i kushtuar rëndësi të veçantë sigurisë kibernetike për të pamundësuar në nivelet më të larta të mundshme ndërhyrjet e paautorizuara nga jashtë dhe nga brenda sistemeve.

Ndër veçoritë kryesore të rritjes së nivelit të sigurisë kibernetike është vetëdijesimi i të gjithë fakorëve të brendshëm dhe të jashtëm, në mënyrën e përdorimit të mjeteve kibernetike si dhe rreziqeve të mundshme që mund të vijnë nga pakujdesitë.

Në këtë drejtim KOSTT sha ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm, si:

- Krijimi i politika të reja në sektorin e TIK, të cilat janë detajuar dhe prekin poashtu teknologjitë e reja, duke u munduar të minimizojnë rreziqet me të cilat ballafaqohemi
- Zbatimin e rreptë të politikave të TIK, sidomos ato të shkëmbimit të informatave me palë të treta si dhe mënyrën e qasjes në dokumente dhe informatat e paverifikuara.
- Zbatimin e teknikave dhe teknologjive moderne që monitorojnë dhe sigurojnë qasjen në internet, si përdorimin e routerave (fireuall) modern.
- Zbatimin e teknikave të sigurisë në qasje deri në nivel të dokumentit.
- Krijimin e sa më shumë sistemeve të dedikuara, që minimizojnë nevojën e përdorimit të sistemeve të paverifikuara

Në kuadër të zhvillimit të sigurisë kibernetike, duhet pasur parasysh se kemi të bëjmë me një qasje sistematike, e jo sistematike, prandaj orientimi duhet të jetë nga 3P:

- Personelit (përdoruesit, monitoruesit, administratorët)
- Procedurat (politikat, proceset, përmirësimet etj)
- Pajisjet – (Sistemet harduerike, softuerike dhe platformat)

Duke u bazuar ne strategjinë për Sigurinë Kibernetike te kompanive qe i perkasin fushës energjetike duke përfshire por jo kufizuar Evropën, stafi i sektorëve te teknologjisë informative dhe asaj operacionale vije ne konkludim se paku katër parimet kryesore duhet te ndjekin si udhëzues për te arritur një qëllim për mbrojtjen ndaj ndonjë sulmi të mundshëm.

Identifikimi i Strategjisë se Sigurisë Kibernetike ka katër parime:

1. Një ekip, një luftë; 2. Metodologjia e administrimit të rrezikut; 3. Planifikimi dhe burimi i prioriteteve ;4. Bashkëpunim i gjerë i ndërmarrjeve Energjetike

Sektori i Teknologjisë se Informacionit dhe Komunikimit do t'i zbatojë këto katër parime me qëllime të Strategjisë se mbrojtjes ndaj sulmeve te mundshme

1. Monitorimi i sistemit te teknologjisë se informacionit dhe teknologjisë operacionale me cilësi të lartë dhe me një ekip të përbashkët; 2. Përmirësimi i vazhdueshëm i sigurisë të qasje në internet; 3. Tranzicioni i teknologjive te përditësuar ne kuadër te testimave nga expertet e brendshëm; 4. Migrimi i sistemeve teknologjike dhe digjitale ne kuadër te standardeve ISO

Për më shumë, ne jemi në zhvillim e sipër dhe të orientuar që të avancojmë me theks të veçantë, duke:

- Trajnuar personelin që të jetë i aftë të dallojë komunikimet e verifikuara nga ato të paverifikuara; - Të përmirësojmë së bashku procedurat, me pikënisje të përmirësimit të shërbimeve dhe sigurisë sa më të lartë; - Të avancojmë pajisjet dhe të përdorim ato aktualet me kapacitete të larta; - Përpilimi i dokumentit për strategjinë e Sigurisë Kibernetike; - Të planifikojmë menaxhimin e riskut

Swissgrid përkrahë KOSTT në drejtim të të bërit Zonë/Blok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale



Në Aarau të Zvicrës në selinë qendrore të Swissgrid, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT sh.a z. Ilir M. Shala së bashku me bashkëpunëtorë, u prit në takim nga homologu i tij Kryeshefi Ekzekutiv i Operatorit të Sistemit Transmetues të Zvicrës, z. Yves Zumwald. Në takim, u diskutuan çështjet bilaterale dhe me theks të posaçëm ato që i përkasin KOSTT-it, gjegjësisht bërjen e KOSTT-it të pavarur si Zonë/Blok Rregullues brenda Evropës Kontinentale, ku përkrahja dhe kontributi i Swissgrid nuk do të mungojë.

Në përmbyllje, z. Shala falënderoi përzemërsisht z. Zumwald për mikpritjen dhe përkrahjen e ofruar.

Kryeministri i Kosovës z.Ramush Haradinaj vizitoi KOSTT-in, pas rezultatit të arritur në drejtim të operimit të pavarur si Zonë/Blok Rregullues në kuadër të Evropës Kontinentale



Me 2 Korrik 2019, në ambientet e ndërtesës qendrore të KOSTT, menaxhmenti në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Illir M. Shala, pritën në takim Kryeministrin e Kosovës z.Ramush Haradinaj me bashkëpunëtorë.

ç'rast Marrëveshja e re e Kycjes me ENTSO-E do të ndërtohet konform vendimeve të votuara në mbledhjen e 52-të të RGCE. "Falë përkushtimit të vazhdueshëm maksimal të KOSTT dhe mbështetjes së institucioneve shtetërore, si dhe miqve tanë ndërkombëtar: Ambasadës Amerikane, Ambasadës Gjermane, USAID, KfW dhe miqve tjerë ndërkombëtar në sensibilizimin e çështjes, u arrit ky rezultat dhe më së

z.Shala njoftoi Kryeministrin Haradinaj për së afërmi në lidhje me procesin e votimit të fundit të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të RGCE/ENTSO-E (Grupi Regjional i Evropës Kontinentale), me largu deri më 14 prill 2020 KOSTT do të operoj i pavarur si Zonë/Blok Rregullues në kuadër të Evropës Kontinentale", theksoi z.Shala.

Me këtë rast, Kryeministri Haradinaj përgëzoi menaxhmentin dhe punonjësit e KOSTT për suksesin, duke e cilësuar si zhvillimin më të mirë dhe më të madh për vendin në fushën energjetike në Kosovë. "Ky institucion mbetet adresë e rëndësishme për tregun e energjisë elektrike në vend dhe energjia një nga parametrat kryesor për siguri dhe zhvillim ekonomik, dhe përkrahja e Qeverisë nuk do të mun-



gojë asnjëherë”, theksoi Kryeministri Haradinaj.

Në kuadër të takimit gjithashtu u diskutua rreth krijimit të Task Forcës për përgatitjet para operimit të KOSTT si Zonë/Blllok Rregullues, për pozicionimin e KOSTT jashtë Ligjit të ri për paga si dhe nevojën për konstituimin e bordit të drejtorëve të kompanisë.

Në përvjetorin e 13-të të themelimit të KOSTT sh.a si Operator i Sistemit Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, delegacioni i Kryeministrit Haradinaj gjithashtu vizitoi Qendrën Nacionale Dispeçerike në KOSTT prej nga u njoftuan rreth operimit në kohë reale të Sistemit Transmetues së Republikës së Kosovës.

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT merr pjesë në Javën për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kosovë



Në ditën e dytë të konferencës e cila po mbahet në kuadër të Javës për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kosovë/Kosovo Sustainability Development Week, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala ishte pjesë e panelit ku u diskutua rreth benefiteve nga integrimi rajonal i tregut të energjisë elektrike.

Me këtë rast z. Shala fillimisht foli rreth karakteristikave të tregjeve të energjisë në Evropën Juglindore si dhe rëndësisë dhe përfitimeve nga integrimi i këtyre tregjeve në shërbim të një të ardhme të qëndrueshme të sektorit të energjisë.

Duke prezentuar nismat aktuale rajonale në këtë drejtim, z. Shala vuri theks në projektin aktual të bashkimit të tregut të energjisë elektrike Kosovë-Shqipëri dhe benefitet e shumta që ofron kjo iniciativë duke marrë parasysh komplementaritetin e të dy sistemeve energjetike. “Rritja e sigurisë së furnizimit me energji elektrike për të dyja vendet, diversifikimi i burimeve të energjisë e cila do të ndikojë gjithashtu edhe në përmirësimin e kontrollit të sistemit energjetik dhe rezervave të sistemit, si dhe tërheqja e investimeve në kapacitete të reja gjeneruese me theks në burime të ripërtërishme të energjisë (BRE), janë vetëm disa nga përfitimet nga tregu i përbashkët. Gjithashtu, së shpejti pritet të finalizohet edhe themelimi i Bursës Shqiptare të energjisë (APEX), ku KOSTT do të marrë pjesë me aksione të barabarta dhe së bashku me OST Shqipëri do të administrojnë tregjet e energjisë elektrike ditore dhe të bëjnë hapin e parë drejt integritimit në tregun rajonal” theksoi z. Shala.

Java për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kosovë është konferencë vjetore që organizohet nga Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Zyrën e Bashkimit Evropian, Bashkëpunimin Gjerman për Zhvillim (GIZ) dhe Konsorciumin Kosovar të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID).

Përgjegjësia Shoqërore e Korporatave (CSR) - Koncept menaxhimi për të rritur impaktin pozitiv në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm



Zana Bajrami-Rama

*Menaxhere e Zyrës për Komunikim dhe Relacione me Publikun/
Përfaqësuese e KOSTT sh.a në Kosovo CSR Network*

Përgjegjësia Shoqërore Korporative (PShK/CSR) është një koncept mjaft i zhvilluar në botë, përderisa në vendet e rajonit përfshirë dhe Kosovën është një koncept relativisht i ri. Sipas standardit ndërkombëtar ISO 26000, me Përgjegjësinë Shoqërore të Korporatave nënkuptojmë përgjegjësinë e një organizate për ndikimet që kanë vendimet dhe aktivitetet e saj në shoqëri dhe mjedis, përmes sjelljes transparente dhe etike. Këto përgjegjësi:

- kontribuojnë në Zhvillim të Qëndrueshëm, përfshirë shëndetin dhe mirëqenien e shoqërisë;
- marrin në konsideratë pritjet e palëve të interesit;
- janë në përputhje me ligjin në fuqi dhe është në përputhje me normat ndërkombëtare të sjelljes;
- si dhe janë të integruar në të gjithë organizatën dhe praktikën e saj. Përtej obligimeve ligjore që kanë kompanitë, sipas Komisionit Evropian, ato duhet të kenë të vendosur një proces për të integruar shqetësimet që ndërlidhen me shoqërinë, mjedisin, të drejtat etike njerëzore dhe shqetësimet e konsumatorëve, në veprimtarinë e tyre afariste dhe në strategji themelore në bashkëpunim të ngushtë me palët e tyre të interesit. Në anën tjetër, ka edhe shtete, siç është India, e cila që nga prilli i vitit 2014 ka bërë PShK-në të detyrueshme duke i obliguar kompanitë që një pjesë të fitimeve të tyre pas tatimit t'a investojnë në fusha të ndryshme të PSHK-së.

Në Kosovë, në vitin 2011 u themelua Rrjeti i Kosovës për Përgjegjësi Shoqërore Korporative, e njohur si CSR Kosova. KOSTT sh.a është anëtare që nga themelimi i rrjetit dhe ka kontribuar për disa vite me radhë edhe në Bordin e Rrjetit përmes përfaqësueses së saj. CSR Kosova u themelua nga ana e liderëve të shquar të bizneseve kosovare dhe ndërkombëtare, të cilët ishin të përkushtuar që të shpërndanin filozofinë e CSR/PShK në komunitetin biznesor si dhe ngritjen e vetëdijes për të zbatuar praktikën më të mira të PShK-së për të rritur impaktin në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm.

KOSTT sh.a e konsideron PShK-në si një proces përmes së cilës kontribuon në zhvillim të qëndrueshëm. Kjo bazohet, fillimisht, në mënyrën se si operon duke inkorporuar politikat e biznesit të përgjegjshëm në politikat e brendshme të kompanisë, ushtrimit të veprimtarisë së vet për të siguruar funksionimin e sigurtë dhe të besueshëm të Sistemit të Transmetimit dhe përmes tij për të krijuar kushte për sigurinë e furnizimit me energji elektrike si një nga përgjegjësitë primare ndaj shoqërisë. Sigurimin e transparencës dhe jo diskriminimin në tregun konkurrues të energjisë elektrike, funksionimin në përputhje me politikat e qeverisjes korporative, dhe gjithashtu kujdes i kushton mirëqenies, zhvillimit dhe trajnimit të punonjësve, ndërkaq theks të veçantë i vë sigurisë në punë gjë që është esenciale për një kompani që ka të bëjë me energji elektrike të tensionit të lartë. Në këtë drejtim KOSTT edhe është çertifikuar me standardin ndërkombëtar OHSAS 18001:2007. PShK është gjithashtu edhe pjesë përbërëse e Strategjisë së Komunikimit të KOSTT.

Derisa në Kosovë aktivitetet e CSR në masë të madhe janë të orientuara kah filantropia, përgjegjësitë e KOSTT shkojnë përtej aktiviteteve filantropike, duke realizuar projekte në shërbim të komunitetit, duke adresuar çështjet ambientale dhe në këtë drejtim KOSTT është çertifikuar me standardin ndërkombëtar ISO 14001:2015. Tutje, duke krijuar kushte për kyçjen e burimeve të ripërtërishme të energjisë në rrjetin e transmetimit, diversifikimin e burimeve të energjisë për konsum të brendshëm me instalimin e burimeve alternative të energjisë-paneleve solare fillimisht në ndërtesën qendrore të kompanisë,

largimin e materialeve të rrezikshme për shëndetin nga objektet e KOSTT, e kështu me radhë. Në vitin 2015, shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, adoptuan Agendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, e cila definon 17 Qëllime të Zhvillimit të Qëndrueshëm/Sustainability Development Goals (SDG's) me 169 objektiva, përmes së cilave adresohen sfidat globale me të cilat përballemi, përfshirë ato që lidhen me varfërinë, pabarazinë, klimën, degradimin e mjedisit, prosperitetin dhe paqen e drejtësinë. Tani SDG-të ofrojnë një kornizë të fuqishme për bizneset që të përfshihen në aktivitete të Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatave. Pikërisht kjo është një nga orientimet që KOSTT duhet të marrë në të ardhmen e afërt, për të përcaktuar rolin që mund të marr për të kontribuar në arritjen e agendës globale për zhvillim të qëndrueshëm, për njerëzit dhe planetin.



Source: UN, Department of Economic and Social Affairs

Ambasadorja e Finlandës Sh.S.znj. Stjernvall ligjëroi pranë të rinjve të KOSTT të përzgjedhur për programin e lidërshiptit

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT sh.a., z. Ilir M. Shala me bashkëpunëtorë gjatë muajit Maj, priti në vizitë Ambasadorën e Finlandës Sh.S.znj. Pia Stjernvall, e cila në kuadër të kësaj vizite, para grupit të përzgjedhur për programin e lidërshiptit në KOSTT, mbajti një ligjeratë me temën “Udhëheqja, ndryshimi dhe menaxhimi i konfliktit”.

Programi për lidërshiptit 50/50 në KOSTT, iniciativë kjo e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT z Shala, e cila ka për synim pjesëmarrjen në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe udhëheqëse të punonjësve të përzgjedhur në përmbushje të zotimeve në balancimin e barazisë gjinore në kompani. Prej 10 anëtarë të stafit, 5 janë përzgjedhur të jenë gra dhe 5 sish burra.

Ndër të tjera, z. Shala falënderoi Ambasadorën Stjernvall, për gatishmërinë dhe bashkëpunimin në drejtim të avancimit profesional të të rinjve të KOSTT duke sjellur praktikat më të mira, bazuar në eksperiencën gjatë misionëve të saja diplomatike ndër vite.



KOSTT sh.a hap dyert për tregun dy ditor, në përkrahje të produkteve bujqësore vendore

Në vazhden e promovimit të praktikave më të mira të përgjegjësisë shoqërore korporative si dhe përkushtimit për avansimin edhe më të lartë të imazhit të kompanisë, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT sh.a, me mbështetjen e Komunës së Prishtinës dhe Komunës së Obiliqit (Kastriot), më datë 05 dhe 06 Shtator 2019, organizoi aktivitetin “KOSTT sh.a hap dyert për tregun dy ditorë në përkrahje të produkteve bujqësore





vendore”, i cili u realizua në kopshtin e selisë qendrore të KOSTT-it në Prishtinë si dhe njëkohësisht në hapësirat e ekipeve të mirëmbajtjes në Obiliq (Kastriot), ku krijoi mundësi duke lëshuar hapësirat pa pagesë/falas për prodhuesit e ndryshëm të produkteve bujqësore vendore, që të ofrojnë produktet e tyre për shitje, për punonjësit e KOSTT-it si dhe për të gjithë qytetarët e interesuar, duke kontribuar në zhvillimin dhe shpërndarjen e kulturës së blerjes së produkteve vendore.

Në mënyrë që ky aktivitet të zhvillohet konform masave administrative dhe ligjeve në fuqi, KOSTT sh.a paraprakisht ka ndërmarrë të gjitha masat e duhura për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti, duke u kujdesur që produktet nga prodhuesit pjesëmarrës, të jenë vendore, natyrale/organike si dhe të posedojnë Certifikatën e Numrit Identifikues të Fermës-NIF Fermerët/Prodhuësit konform Udhëzimit Administrativ NR.07/2011 për Regjistrin e Fermerëve.

Me këtë rast, KOSTT sh.a, ftoi qytetarët dhe institucionet, që veprojnë në afërsi të KOSTT ti bashkohen iniciativës në përkrahje të produkteve vendore në mbështetje të praktikave më të mira evropiane, duke i shërbyer komunitetit si dhe duke i bërë pjesë të pandashme të objektivave tona dhe njëkohësisht duke promovuar përgjegjësitë shoqërore korporative.

KOSTT sh.a pjesë e programit të lidërshiptit ekzekutiv për çështje gjinore GEELP



Arjeta Gashi
Menaxhere e Sektorit të Administratës

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, KOSTT, si palë perspektive është përzgjedhur për të i'u bashkëngjitur programit të lidërshiptit ekzekutiv të çështjeve gjinore GEELP. Ky program financohet nga Qeveria e SHBA-së nëpërmjet USAID, dhe realizohet nga universiteti i njohur Amerikan Georgetown University.

Programi është një proces në vazhdimësi, i cili për qëllim kryesor do të ketë avancimin e çështjeve gjinore në kompanitë të dominuara tradicionalisht nga gjinia mashkullore, siç janë kompanitë energjetike.

KOSTT i është përgjigjur kësaj mundësie për pjesëmarrje në këtë program, duke besuar se barazia gjinore në industri energjetike, është vlerë e cila i ndihmon kompanitë në arritjen e caqeve dhe objektivave biznesore. Po ashtu, avancimi i të drejtave dhe barazisë gjinore, ndikon edhe në përmirësimin e mëtejshëm të kënaqësisë së punëmarrësve, zvogëlon humbjet dhe rritë produktivitetin në punë.

Eksperienca dhe dija e fituar nga ky program, do të jetë një mundësi që KOSTT të përfitojë përvoja interesante dhe t'i aplikoj ato për të mirën e kompanisë dhe të të gjithë punonjësve.

Përfaqesues nga KOSTT në këtë program janë Alban Imeri, Arjeta Gashi dhe Arijeta Pajaziti. Në Qershor 2019 u mbajt moduli i parë i programit në Amsterdam ku përfaqësuesve nga KOSTT iu është bashkëngjitur edhe Kryeshefi Ekzekutiv Ilir M. Shala duke mbajtur takime me homolog te vendeve te ndryshme

të botës të cilët janë pjesë e këtij programi. Me këtë rast Kryeshefi Ekzekutiv z. Ilir M. Shala ka mbështetur këtë iniciativë duke iu drejtuar të gjithë Drejtorëve Ekzekutiv se “Investimi në avancimim e grave në energji nuk është vetëm i drejtë, por gjithashtu është i zgjuar”. Ekipi nga KOSTT do të vijojnë pjesëmarrjen deri në implementimin e plotë të programit duke u angazhuar në arritjen e objektivave sipas udhëzimeve të USAID dhe Georgetown University.



Photo credits: Ryan Kilpatrick/USAID

Nga Tetori 2019, qendra e Prishtinës me furnizim më të besueshëm dhe kualitativ me energji elektrike - *Kryeqytetit i shtohet edhe një Nënstacion me teknologjinë e fjalës së fundit*

Falë realizimit të investimit të përbashkët nga ana e KOSTT dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), qytetarët e Prishtinës me theks të veçantë qendra e kryeqytetit, nga sot do të kenë furnizim më të besueshëm dhe kualitativ me energji elektrike, nga aspekti i transmetimit.

Në kuadër të këtij projekti, për herë të parë në kryeqytet është ndërtuar linjë e dyfishtë nëntokësore kabllore 110kV me gjatësi prej 3.85 km që lidhë Nënstacionin Prishtina 4 (Lagja Veternik) me Nënstacionin Prishtina 6 (Bulevardi Bill Clinton), gjithashtu është ndërtuar nënstationi i ri 110/10 (20) kV Dardania (Prishtina 6) me stabilimente të brendshme të izoluara me gaz SF6 (Gas Insulated Switchgear – GIS), i cili do të operoj me 2 transformatorë energjetik me fuqi 40 MVA (mega volt amper).

Me rastin e lëshimit në punë (energizimit) të Nënstacionit, Kryeshefi i KOSTT z.Illir M. Shala theksoi “Ky investim është edhe një vepër e KOSTT në drejtim të përmbushjes së misionit për të siguruar shërbime kualitative duke implementuar arritjet tekniko teknologjike në zhvillimin e Sistemit të Transmetimit. Me këtë, qytetarëve të Prishtinës i’u është krijuar mundësia për furnizim më stabil, më cilësor dhe më të sigurtë me energji elektrike.”

Sistemi i mbyllur GIS i cili është aplikuar në këtë projekt është fjala e fundit e teknologjisë së pajisjeve të tensionit të lartë dhe këto stabilimente nga aspekti i sigurisë janë shumë të besueshme për operim të njohura në botë për zero aksidente, nuk e ndotin mjedisin, nuk kanë nevojë për mirëmbajtje për 40 vite përkatësisht tërë jetëgjatësinë e pajisjeve si dhe falë dimensioneve të vogla dhe instalimit të brendshëm janë të përshtatshme pikërisht për ambiente të banueshme në qytete siç është rasti në Nënstacionin Dardania (Prishtina 6).

Ky projekt i KOSTT në vlerë prej € 7,506,757.10 është financuar përmes kredisë së butë komerciale në kohëzgjatje prej 12 viteve, të cilën KOSTT e ka siguruar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Investimi i realizuar gjithashtu krijon kushte të favorshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të kryeqytetit.



Vajzat marrin leadershipin në KOSTT për të promovuar fuqi të barabarta, liri dhe përfaqësim- *KOSTT i bashkohet iniciativës globale #GirlsTakeover / Vajzat marrin përsipër, në Ditën Ndërkombëtare të Vajzës*

Për nder të Ditës Ndërkombëtare të Vajzës, KOSTT sh.a në bashkëpunim me Shoqatën e Grave të Sektorit të Energjisë në Kosovë (SHGSEK/AWESK) i’u bashkua iniciativës globale #GirlsTakeOver, përmes së cilës vajzat e reja kërkojnë fuqi të barabarta, liri dhe përfaqësim.

Me qëllim të mbështetjes së vajzave për të thyer barrierat, që mund të paraqiten nga stereotipet dhe që mund të ndikojnë në portretizimin e vajzave dhe rolit të tyre në zhvillim ekonomik e posaçërisht

në sektorin e energjisë, KOSTT sh.a duke i'u bashkuar iniciativës #GirlsTakeover ka synuar që të promovoj fuqizimin e vajzave/grave në vendimmarrje, profesionet në lëmin e energjetikës dhe në përgjithësi punësimin e barabartë të grave në sektorin e energjisë, në të cilin vajza/gruaja jep kontribut të pazëvendësueshëm në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.



Në aktivitetin i cili u organizua nga KOSTT me datë 11 Tetor 2019, vajzat e moshës 14-18 vjeçare fillimisht patën rastin që të informohen më shumë për sektorin e energjisë dhe rolin e KOSTT në këtë sektor, si dhe zhvilluan një takim me Kryeshefin Ekzekutiv të KOSTT z. Ilir M. Shala dhe zv.Kryeshefin e KOSTT z.Kadri Kadriu. Në kuadër të takimit, ata zhvilluan bisedë inspiruese me vajzat në drejtim të rritjes së vetëdijes për të drejtat e tyre të barabarta si në shoqëri ashtu edhe për shkollim dhe synim për t'u avancuar në pozita vendim-marrëse në të ardhmen

e tyre duke u bazuar në meritë. Z.Shala dhe z.Kadriu folën edhe për përparësitë e punës në sektorin e energjisë, ku njëherit punojnë edhe prindërit e vajzave që ishin pjesëmarrëse në këtë aktivitet.

“Isha i impresionuar me pikëpamjet që vajzat kishin për të ardhmen dhe interesimin që shfaqën për t'u informuar se si funksionon sektori i energjisë. Jam shumë i gëzuar që kemi një rini të shëndoshë, të zgjuar dhe të mirë informuar me trendët botërore dhe për më tepër jam i lumtur që i jemi bashkuar iniciativës botërore për të promovuar fuqizimin e vajzave”, theksoi Ilir M. Shala, Kryeshef Ekzekutiv i KOSTT sh.a.

Përmes kampanjës #GirlsTakeover/ Vajzat marrin përsipër, vajzat e reja në të gjithë botën do të hyjnë në një rol udhëheqës me datë 11 tetor 2019 dhe në kuadër të organizimit që zhvilloi KOSTT me këtë rast, dy vajza 14 vjeçare Blinera dhe Nina, morën rolin udhëheqës në takimin i cili u zhvillua me Departamentin e Projekteve. Së bashku dhe me të gjitha vajzat pjesëmarrëse ato mësuan se si udhëhiqet një takim dhe u njoftuan me progresin e projekteve aktuale për zhvillimin e Sistemit të Transmetimit të Kosovës.

“Kjo ishte një përvojë që s'e kisha provuar asnjëherë, ishte interesante ndjenja e të qenurit udhëheqës ... nuk e di, mbase një ditë do të kem me të vërtetë një rol të tillë”, u shpreh Blienera me këtë rast.

Artina, Blerina, Blinera, Festa, Gresa, Mjellma, Nina, Sara dhe Vita ishin të lumtura që patën rastin të bëhen pjesë e kampanjës botërore për të promovuar fuqizimin e vajzave në të gjithë botën. Ato gjithashtu vizituan edhe Qendrën Nacionale Dispeçerike në KOSTT.

Që nga viti 2012, 11 tetori shënohet si Dita Ndërkombëtare e Vajzës, e cila synon që të adresojë nevojat dhe sfidat, me të cilat përballen vajzat dhe në anën tjetër promovon fuqizimin e vajzave dhe përmbushjen e të drejtave të tyre njerëzore.

